REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	**07.04.2023**
REFERENCË	
PËR:	**z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan**
CC:	**z. Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan** **z. Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan**
NGA:	**z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan**
LËNDA:	**Raport i punës – Muaji Mars 01.03.2023-31.03.2023**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

DKA edhe gjatë muajit Mars ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUES

- Për nderë të festës së 7 Marsit Ditës së Mësuesit, DKA ka organizuar takim me drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave në të cilin takim u ndanë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar në nivel shkolle. Gjithashtu është bërë përzgjedhja e punëtorit më të mirë në nivel Komune për vitin 2023. Të gjitha Shkollat e kanë shënuar këtë ditë me organizime festive.

Konform marrëveshjes së nënshkruar muaj më parë me Caritasin Zvicerran ka filluar realizimi i projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" ku gjatë këtij muaji është mbajtur trajnimi 2 ditor "Zhvillimi i shkathtësive të të rinjve mbi mjedisin" për nxënësit e tri shkollave përfituese të projektit: SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan dhe SHMLM "Shaqir Hoxha" në Shalë.

Përgatitja dhe dërgimi i të dhënave për planin zhvillimor të Komunës dhe dërgimi i tyre tek Departamenti i Urbanizmit dhe përfaqësuesit e organizatës të cilët mirren me qështjen në fjalë.

Konform kërkesës nga SHPIK (Shoqata Profesionale të Informaticientëve të Kosovës) dhe MASHT-i në lidhje me implementimin e projektit për ngritjen e klubeve të kodimit në SHFMU dhe SHML kemi dërguar të dhënat për grupet e kodimit (të dhënat për mësimdhënësit e lëndës së TIK-ut).Ky projekt synon avancimin e shkathtësive digjitale të nxënësve dhe mësimdhënësve të fushës Jeta dhe Puna.

Dërgimi i të dhënave në MASHT për numrin e asistentëve në shkolla, qendrën burimore në Magure si dhe të dhënat për stafin aktual 2023 në DKA.

Nxënësit e klasës së VII[1] nga Shfmu "Hasan Prishtina" në Llugaxhi kanë marrë pjesë në projektin e realizuar nga Shkolla Dimërore e Skijimit, saktësisht projekti "Drejt Malit" në bashkëpunim me Masht Projekti ka pasur për qëllim promovimin e kapaciteteve të Kosovës për zhvillimin e sportit malor – skijimit. Ky projekt është realizuar në Brezovicë nga data deri më datën.

Komisioni komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka vazhduar me vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta,ekipi në fjalë është pothuajse në përfundim të vlerësimit të të gjitha rasteve në të gjitha shkollat e Komunës.

6 shkolla nga Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me DKA për nderë të ditës ndërkombëtare të fëmijëve me Sindrom Down kanë mbështetur aktivitetin "Një kartolinë për ty". Aktiviteti në fjalë është përkrahur në vlerë 1322 euro. Përfaqësuesit e Sindromës Down kanë falenderuar DKA dhe shkollat për angazhimin e treguar ndaj këtij akvititeti.

Kërkesë DP-së për zhvillimin e procedurës:

- Furnizimin me kompjuter dhe projektor në IEA-të e Komunës së Lipjanit.
- Ndërrimin e kalldajave në shkollat Shfmu "Ibrahim Banushi" në Shalë dhe SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan dhe
- Furnizimin me pajisje për makinerinë bujqësore në ekonominë bujqësore-Ritenderim.

Kërkesë MASHT-it për:

- Shtimin e numrit të personelit në Çerdhet: Gadime, Sllovi, Shalë dhe Rufc.

Furnizimin me inventar në Çerdhet: Gadime, Sllovi, Shalë dhe Rufc

Nënalokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë:

a). Paga&meditje
b). Mallra&komunali
c). Komunali

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime – kthimi nga lehonia, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrimi i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

STATISTIKAT

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takime të ndryshme me qytetarë, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin.
- Takim me përfaqësues e Forumit të aftësisë së Kufizuar, qëllimi i takimit ishte nënështkrimi i marrëveshjeve rreth angazhimit të 3 asistentëve, konform marrëveshjes së nënshkruar mes Forumit dhe Komunës.
- Takime me përfaqësues të UNICEF-it me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe të vazhdueshëm.

SFIDAT

- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t'i vlerësoj të gjithë në kohë reale.

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.